

Pas titujtve bombastik shpesh fshihen media me përmbajtje të kopjuara dhe të pa verifikuara

Në mësimet e gazetarisë, ekziston një rregull i veçantë për të shkruar titullin e një përmbajtjeje që duhet të bëhet publike dhe të arrijë një audiencë të caktuar. Më saktësisht, funksioni kryesor i titullit është të thuash sa më pak fjalë dhe në atë pak, të jepet fakti më i rëndësishëm i gjithë lajmit. Duhet të jetë një informacion i shkurtër për lexuesit që të kenë një ide të qartë se për çfarë bëhet fjalë në tekstin që është ofrohet. Titulli gjithashtu ka tre epitete që e karakterizojnë: precizionin, goditjen dhe tërheqjen. Sidoqoftë, në ditët e sotme, titujt bombastik gjithnjë e më shumë shfaqen në faqet elektronike të destinuara për informacion. Sensacionalizmi është i dëmshëm për besueshmërinë e gazetarisë dhe mund të ketë shumë pasoja të dëmshme.

Aktualisht ekziston një situatë krize për shkak të shfaqjes së koronavirusit e cila është shpallur si pandemi në të gjithë botën. Në përpjesëtim me përhapjen e virusit, janë përhapur dhe shumë tituj gazetaresk në lidhje me KOVID-19 që në të vërtetë përfitojnë nga situata. Një shembull i një titulli të tillë është si vijon: **" SHOK PROGNOZA e shkencëtarit rus: Virusi Korona vetë do të shkatërrohet (FOTO)"** botuar në portalin në internet **ulica.mk.** Është e qartë se gazetari përdor një "karrem", - ai përdor një fond shkronjash të madha për të tërhequr vëmendjen, dhe vetë titulli fillon me fjalën SHOK.




I njëjti lajm me pothuajse të njëjtën përkthim të përmbajtjes së tekstit u botua edhe në portalet në internet: **index24.mk, tocka.com.mk** dhe **opusteno.mk.**



Në këto tekstet gazetareske përdoret deklaratat e prof. Dr Ancha Baranova, profesoreshë në Universitetin e Biologjisë Sistemike në Virxhinia, SHBA. Duhet të theksohet se përmbajtja e botuar gazetareske nuk përmban të dhëna se nga cila shtëpi e mediave është dhënë deklarata ose nga janë marrë deklaratat e saj të cituara fjalë për fjalë. Kjo shtron pyetjen nëse këto deklarata janë të rëndësishme dhe sa e vërtetë është e gjithë histori. Në procesin e analizimit të tekstit, unë arrita në përfundimin se ai ishte përkthyer nga portali në internet **in4s.net**, me adresën e specifikuar të kontaktit në Kubë *(Calle Lamparilla 110 e, San Ignacio, Havana, Kuba)* dhe impresium i përbërë nga të dhënat e 7 gazetarëve, me kryeredaktor dhe redaktorpërgjegjës Félix Savónin.

Pasi kërkova emrin dhe mbiemrin e redaktorit në internet, nuk gjeta një person tjetër që quhet kështu, përveç një boksieri të njohur kuban. Duke marrë parasysh këtë informacion, ne

kemi dyshime se sa portali **in4s.net** ofron përmbajtje relevante të përmbledhura dhe të verifikuar, që ato të kopjohen dhe përkthehen në mënyrë që të informojnë publikun.



Në videon e publikuar nga prof. Doktor Ancha Baranova, të cilën e gjeta pas një kërkimi të shkurtër në internet, thotë qartë se virusi nuk zhduket dhe nuk vetë-shkatërrohet, por se dobësimi i tij arrihet kur shumohet në kushte të reja, kështu që bëhet më pak i transmetushëm me zhvillimin e tij të mëtutjeshëm. .



Duke e parë atë nga një kënd tjetër, nuk është aspak skandaloze nëse lajmet transmetohen nga një media serioze dhe relevante. Problemi lind kur informacioni i përcjellë nuk verifikohet, por vetëm është përkthyer dhe i është shtuar më tej një titull sensacional. Ka portale në internet që shpesh tërheqin vëmendjen me titujt e përmbajtjes që ofrojnë. Këto nuk janë media reale me qëllim të informimit, por për individë ose një grup njerëzish që përdorin Internetin për të përhapur disa informacione që thjesht kopjohen nga diku ose shkruhen me qëllim që të mbledhin klikime. Ata nuk kanë asnjë lidhje me mënyrën se si funksionon media e vërtetë.

Autor:

Danica Sretkoska, 15 vjeçare